

V E N D I M
Nr.532, datë 21.8.1998

**PËR LEJET E TRANSPORTIT TË MALLRAVE PËR TRANSPORTUESIT QË NUK
KANË SELI NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kushtet, kur u jepen lejet për transport ndërkombëtar të mallrave transportuesve, përcaktohen, mbi baza reciproke, në marrëveshjet përkatëse për transport ndërkombëtar rrugor, të nënshkruara në emër të Republikës së Shqipërisë.

Lejet e transportit ndërkombëtar të mallrave lëshohen nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

Çdo transportues që nuk ka seli në Shqipëri duhet të pajiset me lejen përkatëse të transportit ndërkombëtar të mallrave për çdo kamion.

2. Kontrolli i lejeve të transportit ndërkombëtar të mallrave të bëhet nga organet doganore dhe ato të policisë kufitare, në pikat e hyrjes së Republikës së Shqipërisë.

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, në fillim të çdo viti, njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Ministrinë e Rendit Publik për llojet dhe sasinë e lejeve të transportit ndërkombëtar të mallrave që shkëmbehen me çdo shtet, si dhe shtetet, kamionët e të cilave do të përjashtohen nga lejet e transportit ndërkombëtar të mallrave.

3. Refuzimi i hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për kamionët e transportuesve që nuk kanë seli në Shqipëri bëhet nga organet e kontrollit, sipas pikës 2, në këto raste:

- a) nuk janë pajisur me lejen përkatëse të transportit ndërkombëtar të mallrave;
- b) nuk plotësojnë kushtet teknike për qarkullimin në rrugë;
- c) kryejnë kabotazh (transporte brenda territorit të vendit);
- ç) nuk janë të pajisur me dokumentacionin e nevojshëm për transport ndërkombëtar rrugor;
- d) kur gjatë kontrollit rezulton që sasia faktike e mallit nuk është e njëjtë me atë të deklaruar nga transportuesi.

4. Kur organet shtetërore konstatojnë shkeljet e mësipërme, njoftojnë zyrtarisht Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit për targën e kamionit, shtetin ku është regjistruar, shkeljen e kryer dhe të dhënat e tjera. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit njofton shtetin përkatës për refuzimin e hyrjes së kamionit në Republikën e Shqipërisë dhe arsyet e këtij refuzimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano